

FJALA E GUVERNATORIT

Ekonomia shqiptare ka pasur një kah pozitiv zhvillimi gjatë vitit 2023.

Vëllimi i aktivitetit ekonomik ka ardhur në rritje, duke gjeneruar rritje të punësimit e të pagave. Paralelisht me të, inflacioni ka ardhur në rënie, duke përmirësuar fuqinë blerëse të familjeve dhe duke reduktuar pasigurinë për të ardhmen. Së fundi, treguesit kryesorë të shëndetit ekonomik dhe financiar të ekonomisë: borxhi publik, borxhi i huaj dhe treguesi i kredive me probleme, shënuan përmirësim.

Kjo tablo pozitive pasqyroi premisat e shëndosha të zhvillimit të vendit. Përmirësimi i besimit të biznesit dhe familjeve ka nxitur një përqasje pozitive ndaj investimeve dhe konsumit. Po ashtu, kushtet e favorshme monetare dhe financiare kanë nxitur zgjerimin e kërkesës për mallra e shërbime. Në pasqyrim të tyre, kredia për sektorin privat ka ardhur në rritje, duke furnizuar ekonominë me fondet e nevojshme për zgjerimin e aktivitetit dhe për mbulimin e nevojave me likuiditet. Së fundi, ekonomia shqiptare ka përfituar edhe nga rritja e shpejtë e të ardhurave nga turizmi, të cilat kanë kompensuar rënien e eksporteve të mallrave dhe kanë sjellë një përmirësim të dukshëm të bilancit të shkëmbimeve tregtare me jashtë.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka pasur një kontribut të rëndësishëm në këtë tablo zhvillimesh.

Normalizimi gradual dhe i kujdesshëm i qëndrimit të politikës monetare gjatë dy viteve të fundit ka mundësuar funksionimin e qetë të tregjeve financiare, si dhe ka kontribuar në kontrollin e inflacionit dhe në reduktimin e pasigurive për të ardhmen. Rënia e inflacionit në partnerët tanë tregtarë, forcimi i kursit të këmbimit, si dhe reagimi i politikës sonë monetare kanë ndihmuar në rënien e inflacionit. Inflacioni zbriti nga niveli 7.4% në nivelin 4.0% në harkun kohor të vitit 2023.

Parashikimet tona për të ardhmen mbeten pozitive.

Ekonomia shqiptare do të vijojë të rritet gjatë viteve në vijim, duke vijuar të ushqehet nga zgjerimi i konsumit, investimeve dhe i eksporteve shqiptare, e në veçanti nga ato të turizmit. Kjo rritje do të përkthehet në rritje të mëtejshme të punësimit e të pagave, si dhe të mirëqenies së familjeve shqiptare. Nga ana tjetër, inflacioni parashikohet të ulet gradualisht dhe të kthehet në objektivin tonë prej 3% në gjysmën e dytë të vitit.

Banka e Shqipërisë do të vijojë të ndjekë me vëmendje zhvillimet ekonomike dhe do të kujdeset që – nëpërmjet politikës së saj monetare – të krijojë kushtet e përshtatshme për respektimin e objektivit tonë të stabilitetit të çmimeve. Qëndrimi



ynë i politikës monetare – i shprehur nëpërmjet nivelit të normës bazë të interesit – do të synojë të garantojë kthimin e inflacionit në objektiv, në një kohë sa më të shkurtër dhe me kosto sa më të ulëta mbi aktivitetin ekonomik. Gjithashtu, ky qëndrim do të jetë konsistent me balancën e presioneve të përgjithshme inflacioniste, me politikën fiskale dhe me ecurinë e kursit të këmbimit, si faktorë me ndikim parësor në ecurinë e inflacionit.

